

# AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR "STRINGA GROUP" shpk,

Në Tiranë, sot më datë 17.03.2023, unë i poshtëshënuari Dritan Stringa, i datëlindjes 22.06.1985, banues në Tiranë identifikuar me dokument identifikimi: kartë identiteti me numër personal ,I50622052I, me cilësinë e "ortakut themelues" deklaroj se me vullnet të lirë të plotë, mbeshetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, krijoj shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, "STRINGA GROUP" shpk,

## Neni 1 Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin "STRINGA GROUP" shpk, dhe formë ligjore: "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" e quajtur më poshtë "Shoqëria".

## Neni 2 Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

## Neni 3 Selia

Shoqëria "STRINGA GROUP" shpk e ka selinë në adresë: "Ruga e Kavajes Pallati Nr 56, hyrja 1, Njesia 7, Tirane" dhe mund ta ndryshojë atë me vendim të asamblesë së ortakëve.

## Neni 4 Objekti i veprimtarisë


Objekti i ushtrimit të veprimtarisë për shoqërinë "STRINGA GROUP" shpk është:  
"Nermjetesime pronash truall dhe ndermjetesim biznesi në përgjithësi, import dhe eksport të artikujve industrial, ushqimorë dhe të bimeve medicinale"

## Neni 5 Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj pa afat.

## Neni 6 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërisë është 100,000 lekë, i ndarë në 1(nje) kuote e cila zotërohet si më poshtë:



Dritan Stringa, i datëlindjes 22.06.1985, banues në Tiranë identifikuar me dokument identifikimi: kartë identiteti me numër personal ,I50622052I ,zotëron 100 % të kuotave të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë ,pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta.

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

### **Neni 7 Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.


Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendren Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **Neni 8 Organi Vendimmarrës**

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;



i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.  
Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

#### **Neni 9 Administrimi**

Administrator i shoqërisë **“STRINGA GROUP” shpk** është:  
Dritan Stringa, i datëlindjes 22.06.1985, banues në Tiranë identifikuar me dokument identifikimi: kartë identiteti me numër personal ,1506220521  
Administratori i shoqërisë është i emëruar për një afat 5(pesë) vjeçar. Data e emërimit të tij përkon me datën e themelimit të shoqërisë që është data 17.03.2023. Afati i emerimit të administratorit është deri me 17.03.2028.

#### **Neni 10 Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.  
Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 11 Dispozita perfundimtare**

Ky akt themelimi u redaktua në 3 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.  
Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nën per nen nga ortakut themelues të shoqërisë tregtare **“STRINGA GROUP” shpk**, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën orgjinale.

**ORTAKU THEMELUES  
Dritan Stringa**

Tiranë, më datë 17.03.2023

